



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 nëntor 2011
Nr. ref.: RK 155 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 86/10

Parashtruesit

**Zora Paliç dhe
Pashko Paliç**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.nr. 218/2006, të dates 15 maj 2008, dhe Aktgjykimit të Gjykatës
Komunale në Lipjan P. nr. 177/2002, të datës 9 janar 2003**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesit janë znj. Zora Paliç dhe z. Pashko Paliç, me vendbanim në Lipjan.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimet e kontestuara nga parashtruesit e kërkesës janë:

- a. Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Rev. nr. 218/2006, i cili iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 16 dhjetor 2008; dhe
- b. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan P. nr. 177/2002, i cili iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 3 qershor 2003.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pretendojnë se është shkelur neni 49 [E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 15 shtator 2010, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 nëntor 2010, kërkesa iu përcoll Gjykatës Komunale në Lipjan.
7. Më 7 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 86/10, emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 86/10, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Almiro Rodrigues, Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Më 2 mars 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesit e kërkesës kerkuan nga Gjykata Komunale në Lipjan që t'i rikthej ata në vendet e tyre të punës në shkollën fillore në Janjevë. Më 9 janar 2003, Gjykata Komunale e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazë (Aktgjykimi P. nr. 177/2002).
10. Në Gjykatën Komunale parashtruesit e kërkesës deklaruan se:
 - a. Ata ishin të punësuar të përhershëm për 32 dhe 30 vjet;
 - b. Atyre u ishte mohuar, pa ndonjë bazë, vazhdimi i punësimit nga UNMIK-u;
 - c. Ata morën të ardhurat deri më 31 dhjetor 1999, dhe se ata ishin të punësuar deri më 31 gusht 2000;
 - d. Ata kishin kërkuar nga shkolla, gojarisht dhe me shkrim, që të vazhdonin me punën e tyre; dhe
 - e. Nuk është iniciuar ndonjë procedurë disiplinore kundër tyre dhe asnjë vendim për ndërprerjen e punës nuk iu ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës.

11. Pala e paditur iu përgjigj Gjykatës Komunale se:

- a. Parashtruesit e kërkesës nuk ishin në punë që nga 1 shtatori 2000 deri më 29 shtator 2001;
- b. Shkolla u detyrua të rekrutojë staf të ri për pozitën që ishin mbajtur nga dy parashtruesit e kërkesës, në mënyrë që të ofrojnë mësimdhënie normale për nxënësit, që më parë ishin mësuar nga parashtruesit e kërkesës; dhe
- c. Administrata e UNMIK-ut, Departamenti i Arsimit, u autorizua të vendoste për rekrutimin dhe shkarkimin e stafit të shkollës.

12. Gjykata Komunale deklaroi se:

- a. Koordinatori për Komunitetet Lokale në Lipjan kishte njoftuar parashtruesit e kërkesës se vendet e tyre të punës ishin zënë nga stafi i ri, pasi që ata vullnetarisht kishin lëshuar punën;
- b. Parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur ndonjë kundërshtim tek organet kompetente të shkollës lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre sipas ligjit të punës; dhe
- c. Në bazë të nenit 83.2 (të Drejtat Themelore) të Ligjit për Marrëdhënie të Punës parashihet se mbrojtja e të drejtave nuk mund të kërkohej në gjykatën kompetente, përveç nëse kjo mbrojtje e të drejtave është kërkuar më parë nga organet kompetente të organizatës.

13. Parashtruesit e kërkesës u ankuan në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila hodhi poshtë ankesën e tyre dhe mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, duke theksuar se zbatimi i të drejtës materiale dhe procedurale ishte korrekt (Aktgjykimi Gzh. nr. 394/2003, i datës 14 korrik 2005).

14. Parashtruesit e kërkesës më pastaj u ankuan në Gjykatën Supreme, duke theksuar se:

- a. Gjykatat e rregullta nuk kanë shqyrtuar nëse kishte baza ligjore për ndërprerjen e punësimit;
- b. Nuk ekzistonte dëshmi se parashtruesit e kërkesës e kishin lënë punën vullnetarisht;
- c. Gjykatat e rregullta nuk kishin marrë në konsideratë të gjitha dëshmitë që kishin paraqitur parashtruesit e kërkesës; dhe
- d. Aktgjykimi i gjykatave të rregullta nuk ishte arsyetuar.

15. Gjykata Supreme refuzoi ankesën si të pabazë (Aktgjykimi Rev. nr. 218/2006, i datës 15 maj 2008), duke theksuar se situata faktike dhe e drejta materiale e procedurale ishin aplikuar me korrektësi nga gjykatat e rregullta.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

16. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kontratat e tyre të punës ishin ndërprerë në mënyrë të paligjshme dhe jokushtetuese, pa ndonjë vendim.

17. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kushtetuta garanton të drejtat bazë të qytetarëve, si e drejta për punësim, për çka bëhet fjalë në rastin e tyre.

18. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës deklarojnë se ata janë qytetarë të Kosovës dhe kanë të drejtë për punësim, sepse ata ishin të punësuar për më tepër 30 vjet, sipas kontratës së punës, dhe në këtë mënyrë, është e palogjikshme që punësimi i tyre të ndërpritet pa ndonjë vendim të nxjerrë nga shkolla.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Sa për pretendimet e parashtruesve të kërkesës se është shkelur e drejta e tyre e garantuar me nenin 49 [E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit] të Kushtetutës, Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, është e nevojshme paraprakisht të vlerësohet nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
20. Si një nga kërkesat e parapara për plotësimin e kushteve, parashtruesit e kërkesës duhet të kujdeseshin për të paraqitur kërkesën brenda afatit kohor prej 4 muajsh pas vendimit të fundit të gjykatës lidhur me rastin e tyre, siç edhe përcaktohet me nenin 49 të Ligjit. Sidoqoftë, nga parashtresa e parashtruesve të kërkesës duket se vendimi i fundit gjyqësor lidhur me rastin e tyre, ishte Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i 15 majit 2008, i cili iu dorëzua atyre më 16 dhjetor 2008, përderisa ata e paraqitën kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese tek më 15 shtator 2010, që është më shumë se 4 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit (shih nenin 56 të Ligjit).
20. Nga kjo rrjedh se, në bazë të nenit 49 të Ligjit, kërkesa është e parashkruar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 2 mars 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani